



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK178/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 70/11

Parashtrues:

**Faik Hima
Magbule Hima
Bestar Hima**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr.
983/08, të datës 7 shkurt 2011.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. Nr. 938/08, të datës 7 shkurt 2011, i cili i është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 10 mars 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) mbi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 938/08, me të cilin refuzohet kërkesa e parashtruesve për kthimin e pronës së paluajtshme të shpronësuar në Gjakovë.
4. Parashtruesit e kërkesës ankohen se:
 - a. Palës i është pamundësuar që të paraqes ankesë në Qeverinë Qendrore të Kosovës, ngase vendimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës përmendi një mjet ligjor të gabueshëm. Si pasojë, i është pamundësuar e drejta për qasje efektive në drejtësi;
 - b. Ky rast i shpronësimit u iniciua më 2 maj 2002 dhe u stërzgjat deri tani, andaj edhe u shkelën standardet e vendosura sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj për zgjedhjen e rastit "...brenda afatit të arsyeshëm kohor...", neni 6.1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
 - c. Ka pasur shkelje të parimeve mbi ndalimin e diskriminimit, sepse nuk është aplikuar Ligji i të Drejtës Procedurale dhe Materiale që është ligji më i favorshëm për palën; dhe
 - d. E drejta në pronë, e rregulluar dhe garantuar me nenin 1 – Mbrojtja e Pronës, Protokoli nr. 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, janë shkelur.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 26 maj 2011, parashtruesit e kërkesës ia paraqitën kërkesën e tyre Gjykatës.
7. Më 9 gusht 2011, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme lidhur me kërkesën.
8. Më 17 gusht 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 70/11, emëroi Zëvendëskryetarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 70/11, emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
9. Më 21 nëntor 2011, gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj informoi Gjykatën se, më 21 nëntor 2011, i kishte shkruar Kryetarit të Gjykatës që për shkak të lidhjeve familjare me parashtruesit e kërkesës, ajo do të dëshironte të përjashtohej "*ex officio*" nga pjesëmarrja në procedurat

e Gjykatës në rastin KI 70/11, në përputhshmëri me rregullin 8(1)(1) të Rregullores së punës dhe nenin 18 (1)(2) të Ligjit.

10. Më 25 nëntor 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH 70/11, në përputhshmëri me rregullin 8.2 të Rregullores së punës, zëvendësoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj me gjyqtaren Iliriana Islami si anëtare të Kolegjit shqyrtues.
11. Më 12 dhjetor 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 1 qershor 1984, Departamenti Komunal për Çështje Pronësoro-Juridike në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: Departamenti), shpronësoi pronën e patundshme të familjes së parashtruesve të kërkesës me qëllim të ndërtimit të Monumentit të luftëtarëve të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore (Vendimi 03-463-17/17).
13. Më 2 maj 2002, parashtruesit e kërkesës i parashtruan një kërkesë këtij Departamenti për kthim, pasi që pretendohet se patundshmëria e shpronësuar nuk po shfrytëzohej për qëllimin që ishte shpronësuar. Sidoqoftë, departamenti, me sa duket, kurrë nuk mori një vendim të tillë.
14. Më 12 prill 2007, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Departamenti dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës që të vendosin lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, pasi që Departamenti nuk kishte marrë vendim lidhur me këtë çështje për pesë vite.
15. Më 21 maj 2007, Agjencia Kadastrale e Kosovës urdhëroi Departamentin që të marrë një vendim për rastin e parashtruesve të kërkesës (konkluzioni nr. 03/278/07).
16. Më 30 korrik 2007, Departamenti suspendoi procedurën sepse *“ishte vërtetuar se disa parcela ishin në pronësi të Kuvendit Komunal të Gjakovës”*. Në bazë të vërtetimit të një situate të tillë ky departament konsideron se procedura për këtë çështje duhet përfunduar posa të vërtetohen rrethanat e gjendjes së konstatuar” (Nr. 03-463-17-14/02).
17. Më 18 gusht 2007, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë kundër konkluzionit të Departamentit tek Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Gjakovës që të anulojë konkluzionin e Departamentit.
18. Më 10 shtator 2007, Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Gjakovës e refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazë (Vendimi Nr. 11-03-463-17-14/02).
19. Më 20 shtator 2007, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë kundër vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Gjakovës tek Agjencia Kadastrale e Kosovës.
20. Më 19 nëntor 2007, Agjencia Kadastrale e Kosovës aprovoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të bazuar dhe anuloi vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Gjakovës dhe rasti u kthye për rigjykim në Departament (Vendimi Nr. 799/07), *“pasi që lidhur me këtë çështje specifike asnjë organ tjetër nuk mund të vendosë për këtë çështje administrative përveçse organi që e ka kryer shpronësimin”*.
21. Më 27 qershor 2008, Departamenti refuzoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazë pasi që *“prona e paluajtshme ishte shpronësuar për qëllim të ndërtimit të*

monumentit në “Qabrat” për ushtarët e rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore.” (Vendimi Nr. 03-463-17-14/02).

22. Më 8 korrik 2008, parashtruesit e kërkesës u ankuan tek Kryetari i Komunës së Gjakovës kundër vendimit të Departamentit (në tekstin e mëtejme: Kryetari i komunës).
23. Më 21 korrik 2008, Kryetari i komunës e refuzoi ankesën e parashtruesve të ankesës si të pabazë dhe mbështeti vendimin e Departamentit (Vendimi Nr. 11-03-463-17-14/02).
24. Më 4 gusht 2008, parashtruesit e kërkesës u ankuan në Gjykatën Supreme kundër Kryetarit të komunës.
25. Më 7 shkurt 2011, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesve të kërkesës me arsyetimin se:

“...

Në pajtim me nenin 21 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit për Shpronësimin të KSAK (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të datës 28 prill 1978) është paraparë që vendimi i formës së prerë për shpronësim të anulohet në bazë kërkesës së pronarit të mëparshëm të pronës së paluajtur të shpronësuar, nëse shfrytëzuesi i pronës së shpronësuar për një periudhë kohore prej tre vjetësh, që prej se vendimi ka marrë formën e prerë, nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punimet e nevojshme për atë objekt. Pasi që të kalojnë 10 vjet nga dita kur vendimi për shpronësimin të ketë marrë formën e prerë mbi shpronësimin nuk mund të paraqitet kërkesë për anulimin e atij vendimi.

Ndërsa, sipas dispozitave të nenit 10 (4) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shpronësim (“Gazeta Zyrtare e Kosovës”, e datës 22 nëntor 1986) është paraparë se posa të shpronësohet parcela e tokës vendimi i formës së prerë për shpronësimin do të anulohet përmes kërkesës së paraqitur nga pronari i mëparshëm, nëse në periudhën kohore prej 5 vitesh pas hyrjes në fuqi të vendimit, nuk janë kryer punët në përgatitjen dhe rregullimin e tokës. Pasi që të kenë kaluar 6 vjet nga dita e marrjes së vendimit për shpronësimin nuk mund të paraqitet kërkesë për anulimin e atij vendimi (neni 10 (4)).

Gjykata Supreme konfirmon se paditësit paraqitën kërkesën e tyre për anulimin e vendimit të shpronësimit pas skadimit të afatit kohor të paraparë me dispozitat e lartpërmendura, pasi që paditësit paraqitën kërkesën e tyre për anulimin e vendimit për shpronësim në maj 2002.

...”

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë si vijon:

- a. Kryetari i komunës ka përmendur një mjet të gabuar ligjor duke dhënë këshilla ligjore se ankesa do të duhej paraqitur në Gjykatën Supreme e jo në Agjencin Kadastrale të Kosovës. Si pasojë, ishte pamundësuar e drejta për qasje efektive në drejtësi;
- b. Rasti nuk ishte vendosur “...brenda afatit të arsyeshëm kohor...”;
- c. Gjykata Supreme do të duhej të kishte zbatuar Ligjin e të Drejtës Procedurale e Materiale, Ligj ky më i favorshmi për palën, gjegjësisht nenin 36 t Ligjit të Serbisë për shpronësimin (“Gazeta Zyrtare e RS” 53/95);

- d. Është shkelur e drejta në pronë;
- e. Nuk ka kriter ndërkombëtar ose standard që do të lejonte marrjen e pronës private nga qytetarët dhe mospërdorimin e saj për destinimin e shpronësimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se e drejta e tyre e garantuar me nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës si dhe neni 6 [E drejta për Gjykim të Drejtë] i KEDNJ dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ janë shkelur. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin dhe Rregulloren e punës.
28. Lidhur me këtë, Gjykata thirret në nenin 48 të Ligjit:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
29. Sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose ligjshmërisë që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse ato i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me konventë (kushtetutshmërinë). Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
30. Kështu që, Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat, shikuar në tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të ndershëm (shih *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Apl. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
31. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës thjeshtë kontestojnë nëse Gjykata Supreme ka zbatuar në mënyrë të rregullt ligjin e aplikueshëm dhe shprehin mospajtimin me gjetjet e gjykatave.
32. Pas shqyrtimit të procedurave në Gjykatën Supreme në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vërejtë që në çfarëdo mënyre procedurat relevante të kenë qenë të padrejta ose arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
33. Si konkluzion, parashtruesit e kërkesës as nuk kanë arritur të ndërtojnë rastin për shkeljen e të drejtës së tyre për gjykim të drejtë nga Gjykata Supreme dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tyre (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
34. Prandaj, rezulton që kjo kërkesë është qartazi e pabazë në përputhshmëri me rregullin 36 1. (c) të Rregullores së punës, e cila parasheh se *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.”*


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me rregullin 36 (1c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullore së punës, më 12 dhjetor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Mr.Sc.Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani

